



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 444/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, rr. “Armend Daci” nr. 1 Prishtinë, kundër debitorit “V...” sh.p.k, me NRB 70366136, me seli në fshatin ..., Rahovec, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1076/2019, të datës 13.11.2019, të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës me datën 30.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “V...” sh.p.k, i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.1076/2019, të datës 13.11.2019, të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi.
- II. MBETET NË FUQI urdhri përmbartimor P.nr.1076/2019, i datës 13.11.2019, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Gjokë Radi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me datë 13.11.2019, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.1076/2019, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor Aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr.4767, të datës 21.12.2018, me të cilin është urdhëruar debitori që kreditorit t’ia paguaj shumën e borxhit prej 6,478.50 €, në emër të mos pagesës të rentës minerare, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogaritë e kreditorit, si dhe regjistrimin, konfiskimin, dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe nga shitja e këtyre të realizohet borxhi ndaj kreditorit si dhe të paguhen shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me tarifat në fuqi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se me caktimin e përmbarrimit të propozuar, të njëjtit në mënyrë të përsëritur i shkaktohet dëm i konsiderueshëm dhe i pa riparueshëm, përkundër faktit se në ankesën administrative në mënyrë të argumentuar i ka shtjelluar faktet relevante që do të duhej të vërtetonin të kundërtën e obligimit për të cilën kërkohet përmbarrimit. Ka shtuar se si kompani janë të gatshëm të arrijnë një marrëveshje të pranueshme dhe të realizueshme për mundësitë e tyre financiare i cili propozim është akoma në fuqi, andaj i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqyrtimit të prapësimin të njëjtin ta miratoj si të bazuar, ndërsa urdhrin për përmbarrim ta shfuqizoj.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se i gjithë pretendimi i debitorit është i pa bazuar për faktin se propozimi për përmbarrim i kreditorit, është në përputhje me nenin 22 par. 1.2, nenin 24 par. 3, nenin 27, nenin 36 par. 1 dhe 2, si dhe nenin 38 të LPP-së, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkak të si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarrues ka lejuar përmbarrimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarrimor, përkatësisht Aktvendimin Nr.4767, të datës 21.11.2018, në bazë të së cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarrues sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti Aktvendimin Nr.4767, i datës 21.11.2018, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin

27 paragrafin 1, sipas të cilit: “*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr.4767, i datës 21.11.2018, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: “*Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri*”, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: “*Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë*”, ngase Aktvendimi Nr.4767, i datës 21.11.2018, i nxjerrë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, është bërë i formës së prerë me datë 16.04.2019 dhe i ekzekutueshëm nga data 02.05.2019.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.444/22, datë 30.09.2022

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.